




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-02/217/17
Data Datum Date	31-01-2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4695-16, për Zyrtarin e lartë z.Lazer Ndrecaj-Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-4695/16, për Zyrtarin e lartë, z.Lazer Ndrecaj-Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private "Ekoprojekt" n.sh., dhe "AKK-Financiar" N.Sh., është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Ndrecaj (DPK-03-02-4778-16), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Ndrecaj është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar ndryshimet në biznes (Dpki-03-02/4695/16) dhe (Dpki-03-02-145/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilin shihet se, z.Ndrecaj tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit

person i autorizuar në këto biznese private, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shqip Havolli /